



**HESHTJA
ESHTE
ARMIKU**



YT



2 0 1 8



**Organizuar nga Komisioni për barazi Gjinore
midis burrit dhe gruas**

**Rajoni Autonom Friuli Venezia Giulia
Keshilli rajonal**

**Grupi i punes se Komisionit
“Shendeti dhe Politika sociale kundershtojne dhunen kunder grave”**

Imazhi i kopertines e Micaela Cossettini

**Numerimi faqeve dhe stampimi
Keshilli rajonal i Friuli Venezia Giulia
Sekreteria e pergjithshme**

**I Edizioni 2009
II Edizioni 2012
III Edizioni 2015**

“E vërteta nuk eshte arritur asnjehere me dhune”

M.K.Gandhi

Heshtja eshte armiku yt
Te dalesh nga dhuna mundesh

Heshtja eshte armiku yt 2018

Qershor 2015

Heshtja eshte armiku yt 2018

Problemi i dhunës kundër grave jo vetëm nuk ka shënja ndalese por, sic tregojnë statistikat, vjen duke u shtur: cdo dite dëgjojmë raste të grave viktime të keqtrajtimit, abuzimit dhe dhunës, brenda dhe jashtë shtëpisë, ku shpesh asistojnë edhe fëmijët, me pasoja të rënda për nivelin emocional dhe njohës.

Ky fenomen i tmershem, që nuk njeh moshë apo klasë shoqërore, duhet të trajtohet me vendosmëri duke ndihmuar gratë për të denoncuar, për të dalë nga heshtja, armik i rrezikshëm por shume shpesh prezent.

Qëllimi që Komisioni i Mundësive të Barabarta i Friuli Venezia Giulia synon me këtë broshurë, pra, të tregoj se nga dhuna mudet dhe duhet dale! Frika, pasiguria, vetmia, dëshpërimi bëhen pjese e gruas viktime e abuzimit, duke e bërë atë të pafuqishme; ja perse ne kemi menduar mundesimin e këtij manual që, me qartësi dhe të dhëna të sakta, analizon llojet e ndryshme të dhunës, nga fizike në psikologjike, nga seksuale në ekonomike dhe madje edhe persekutimi, duke treguar rrugën që duhet ndjekur për të arritur në ndihmën konkrete nga qendrat dhe institucionet kompetente.

Një sjellje e dhunshme është serioze dhe e papranueshme, dhe nuk mund të justifikohet në asnjë mënyrë, as nga ana e personave që e ushtrojnë atë, e as nga ata që vuajnë.

Qëllimi i vërtetë i këtij publikimi është të inkurajojë viktimën për të raportuar abuzimin menjëherë me bindje dhe besim, për të thyer heshtjen, dhe kjo duke filluar nga një vlerë etike e pakritikueshme dhe e panegociueshme: RESPEKTI, në emër të dinjitetit njerëzor.

Ne shpresojmë, pra, me anë të këtyre informacione, që bota e grave ti kalojë keto pengesa, edhe pse nepermejt situatash me vuajtje dhe dhimbje, por nepermjet bshkebisedit, në një klimë ndryshimi real dhe te nje emancipimi të vërtetë

Annamaria POGGIOLI
Kryetari i Komisionit rajonal
për mundësi të barabarta midis burrave dhe grave

TE DALESH
NGA
DHUNA
MUNDET

25
nentor
dita internacionale
kunder dhunes
ndaj grave

| Di. Maio Simona | SAUD |

Indice

<i>Ne Friuli Venezia Giulia</i>	11
<i>Dhurat kunder grave</i>	17
<i>Autori i dhunes.....</i>	19
<i>Treguesit se rrezikut.....</i>	22
<i>Vendet e zakonshme</i>	25
<i>Keshilla te dobishme.....</i>	27
<i>Çfare mund te bej?</i>	28
<i>Normativa.....</i>	29
<i>Qendrat under-dhunes</i>	33
<i>Falenderim</i>	34

Heshtja eshte armiku yt 2018

Ne Friuli Venezia Giulia ne 2011

Ne 2011 në rajonin tonë 626 gra jane ndjekur nga Qëndrat kundër-dhunës

331 18-40 vjec	346 41-64 vjec	99 nuk dihet
374 të martuara	211 beqare	106 te ndara
42 të divorciuara	25 vejat	18 nuk dihet
382 te punesuara	81 shtëpiake	159 te papunesuara
101 tjetër	53 panjohur	

Anëtarët sipas llojit të dhunës

449 psicologjike	489 fizike	206 stalking	360 ekonomike	106 seksuale
----------------------------	----------------------	------------------------	-------------------------	------------------------

Pritja në shtëpitë strehimore

64 Grate e asistuar	56 Fëmijet e grave te asistuar	48 Vënde në 8 shtëpi kapacitet maksimal prej pritje (Nga viti 2009)
-------------------------------	--	---

Të dhëna SISS – sistemi informativ social-sanitar

Heshtja eshte armiku yt 2018

Heshtja eshte armiku yt 2018

Ne Friuli Venezia Giulia ne 2012

Ne 2012 në rajonin tonë 737 gra janë ndjekur nga Qendrat kunder-dhunës

362 18-40 vjec	361 41-64 vjec	14 nuk dihet
361 të martuara	222 beqare	87 të ndara
38 të divorcuara	25 vejat	4 nuk dihet
373 te punesuara	68 shtëpiake	188 te papunesuara
99 tjetër	90 nuk i dihet	

Anëtarët sipas llojit të dhunës

681 psicollogjike	499 fizike	166 stalking	345 ekonomike	101 seksuale
-----------------------------	----------------------	------------------------	-------------------------	------------------------

Anëtarët sipas titullit arsimor

35 Shkolla fillore	188 Shkolla e mesme fillore	283 Shkolla e mesme	79 diploma	30 profesionale
------------------------------	---------------------------------------	-------------------------------	----------------------	---------------------------

Pritja në shtëpitë strehimore

86 Gratë e asistuar	85 Femijët e grave te asistuar
-------------------------------	--

Të dhëna SISS – sistemi informativ social-sanitar

Heshtja është armiku yt 2018

Ne Friuli Venezia Giulia ne 2013

Ne 2013 në rajonin tonë 791 gra janë ndjekur nga Qendrat kunder-dhunës

366 18-40 vjec	392 41-64 vjec	30 nuk dihet	
343 të martuara	244 beqare	117 të ndara	
52 të divorcuara	23 vejat	11 nuk dihet	
373 tepunesuara	68 shtëpiake	188 te papunesuara	
99 tjetër	9 nuk dihet		1 burre

Anëtarët sipas llojit të dhunës

736 psicollogjike	506 fizike	172 stalking	311 ekonomike	97 seksuale
-----------------------------	----------------------	------------------------	-------------------------	-----------------------

Anëtarët sipas titullit arsimor

31 Shkolla fillore	197 Shkolla e mesme fillore	281 Shkolla e mesme	107 diploma	54 profesionale
------------------------------	---------------------------------------	-------------------------------	-----------------------	---------------------------

Pritja në shtëpitë strehimore

82 Gratë e asistuar	66 Femijët e grave te asistuar
-------------------------------	--

Të dhëna SISS – sistemi informativ social-sanitar

Heshtja është armiku yt 2018

Ne Friuli Venezia Giulia ne 2014

Ne 2014 në rajonin tonë 764 gra janë ndjekur nga Qendrat kunder-dhunës

369 18-40 vjec	372 41-64 vjec	21 nuk dihet	
343 të martuara	247 beqare	89 të ndara	
45 të divorcuara	19 vejat	21 të ndara	
378 tepunesuara	58 shtëpiake	212 te papunesuara	34 studente
5 tjetër	17 të ndara		

Anëtarët sipas llojit të dhunës

705 psicollogjike	483 fizike	179 stalking	362 ekonomike	127 seksuale
-----------------------------	----------------------	------------------------	-------------------------	------------------------

Anëtarët sipas titullit arsimor

31 Shkolla fillore	205 Shkolla e mesme fillore	276 Shkolla e mesme	120 diploma	53 profesionale
------------------------------	---------------------------------------	-------------------------------	-----------------------	---------------------------

Pritja në shtëpitë strehimore

81 Gratë e asistuar	77 Femijët e grave te asistuar
-------------------------------	--

Të dhëna SISS – sistemi informativ social-sanitar

Heshtja është armiku yt 2018

Ne Friuli Venezia Giulia ne 2015

Ne 2015 në rajonin tonë 775 gra janë ndjekur nga Qendrat kunder-dhunës

362 18-40 vjec	393 41-64 vjec	18 nuk dihet	
371 të martuara	240 beqare	90 të ndara	
43 të divorcuara	16 vejat	3 nuk dihet	
375 tepunesuara	84 shtëpiake	202 te papunesuara	34 studente
16 tjetër	20 nuk dihet		

Anëtarët sipas llojit të dhunës

729 psicollogjike	496 fizike	145 stalking	367 ekonomike	119 seksuale
-----------------------------	----------------------	------------------------	-------------------------	------------------------

Anëtarët sipas titullit arsimor

31 Shkolla fillore	192 Shkolla e mesme fillore	291 Shkolla e mesme	118 diploma	34 profesionale
------------------------------	---------------------------------------	-------------------------------	-----------------------	---------------------------

Pritja në shtëpitë strehimore

76 Gratë e asistuar	82 Femijët e grave te asistuar
-------------------------------	--

Të dhëna SISS – sistemi informativ social-sanitar

Heshtja është armiku yt 2018

KJO NUK ËSHTE DASHURI

25
NENTOR
Dita
internacionale
kunder
dhunes
ndaj grave

Dhuna kundrejt grave

Fizike:

çdo lloj kercenimi ndaj trupit tuaj dhe ate cka te perket ty.

- të tërheq, godet, të kafshon, shkelmon, pështyn, te pickon, djeg me cigare, thyen gjërat e tua.
- të ndalon të lëvizesh, të dalësh
- të ndalon kurat mjeksore, të prish gjumin.

Psikologjike:

shpesh përgatit dhunën fizike sepse të nënvlereson dhe nuk rrespekton identitetin tend si person dhe bën qe e gjithë kjo të duket si një gjë normale

- të kritikon, të poshtëron ose tallet me ty para të tjetëve, të fyen
- të ndalon të shikosh miq dhe shok, të praktikosh interesat e tua
- kërcënon se do të të bëjë keq ty apo fëmijëve
- kërcënon se do ti bëjë keq vetes së tij ose që do vetvritet

Seksuale:

- të detyron për marrëdhënie ose per lojra seksuale kur nuk ke dëshire
- të detyron për të parë ose për të perdorur material pornografik
- të detyron për të pasur marrëdhënie seksuale me njerëz të tjere ose për ti para ata
- të detyron për të pasur marrëdhënie përpara të tjerëve o përpara fëmijëve

Heshtja eshte armiku yt 2018

Ekonomike:

- te përjashton nga vendimet per sa i perket te ardhurave familjare si dhe ceshjeve trashegimore
- kontrollon aftesin tende ne blerje si dhe te ndalon të kesh llogari bankare
- të pengon të kërkosh apo dhe të mbash një punë
- të bën të kesh borxhe ose detyrime financiare pa djenine tende
- nënshruan të gjitha gjërat në emrin e tij edhe pse ti ke ndihmuar me te ardhurat e tua
- refuson të paguajë shumen e te ardhurave per nje jetese te denje.

Persekutimi (stalking)

Kur kerkon qe te largohesh nga nje lidhje e dhunshme dhe te padeshiruar

- të ndjek në cdo lëvizjet dhe të pret kur del nga shtëpia ose nga puna
- të dërgon letra, kërcenime, sms dhe telefonata ne vazhdimesi
- shfaqet papritur në vëndet qe frekuenton zakonisht duke te bere te ndihesh si “ne kurth”

Autori i dhunes**Të dhënat e rasteve te ndjekura në vitin 2011 nga qëndrat kundër-dhunes në Friuli Venezia Giulia**

Partneri (burri, bashkshorti, i fejuari)	481
Ish partneri	147
Familjare	68
Shoku/i njohur/koleg	34
I huaj	6
Dhune grupi	3
Punedhenesi	4
Tjeter	19
Nuk dihet	20

Të dhënat e rasteve të ndjekura në vitin 2012 nga qendrat kundër-dhunës në Friuli Venezia Giulia

Partneri (burri, bashkshorti, i fejuari)	487
Ish partneri	132
Familjare	59
Shoku/ i njohur/koleg	18
I huaj	6
Tjeter	35
Nuk dihet	4

Të dhënat e rasteve të ndjekura në vitin 2013 nga qendrat kundër-dhunes në Friuli Venezia Giulia

Partneri (burri, bashkshorti, i fejuari)	463
Ish partneri	176
Familjare	79
Shoku/ i njohur/koleg	27
I huaj	6
Tjeter	42
Nuk dihet	4

Heshtja eshte armiku yt 2018

Dati dei casi seguiti nel 2014 dai centri anti violenza del Friuli Venezia Giulia

Partneri (burri, bashkshorti, i fejuari)	469
Ish partneri	148
Familjare	57
Shoku/ i njohur/koleg	32
I huaj	-
Tjeter	53
Nuk dihet	4

Dati dei casi seguiti nel 2015 dai centri anti violenza del Friuli Venezia Giulia

Partneri (burri, bashkshorti, i fejuari)	492
Ish partneri	134
Familjare	69
Shoku/ i njohur/koleg	34
I huaj	-
Tjeter	31
Nuk dihet	15

Heshtja eshte armiku yt 2018

Shenja rreziku

- Perceptimi subjektiv i gruas se gjendet në **rrezik**
- Xhelozia **obsesive** dhe **posesive** e partnerit
- Prania e **armave**
- **Dhuna** te mëparshme
- **Shkallëzimi** i dhunës kohet e fundit
- **Raste** veçanërisht serioze dhe mizore
- Dhuna mbi **kafshët shtëpiake**
- **Precedent penal**
- Përdorimi i **alkolit** dhe drogës
- Sjellje agresive dhe të dhunshme **edhe brenda** ambienti shtëpiak

Dhune shtëpiake

Dhuna, statikisht në shumicën e rasteve kryhet brënda murave shtëpiake në një ambient familjar në të cilën modeli relacional është i bazuar në pushtet, duke e përdorur dhe e kontrolluar personin tjetër dhe presupozon një marrëdhënie emocionale të tillë që e bën më të vështirë për ta njohur si dukuri.

Viktima

- Jeton një marrëdhënie të paqartë, ku nuk arrin të dallojë midis nivelit të abuzimit dhe nivelit emocional që vendosen njera mbi tjetren dhe krijojnë **konfuzion**: bashkjeton në fakt, dëshira për të mbajtur të bashkuar familjen dhe në të njëjten kohë vetëdija e nevojshmerise për ti larguar fëmijët nga dhuna
- ndihet e **pazonja** në rolin e saj si nënë
- ndihet përgjegjëse në vazhdimësinë e raportit dhe i vjen **turp** të shprehë sikletin në ambientet e jashtme.
- vetëm në raste shumë të rradha dhuna është e papritur zakonisht ajo është e **përditshme** dhe ka karakteristikat e përsëritjes dhe të vazhdimësisë
- kërcënimi tshme i parashikuar, kronik, në vazhdimësi krijon **ndjesinë e pafuqisë** që bëhet një element qëndror në jetën e viktimave
- gruaja fillon ngadalë ngadalë të zhvlerësohet, të ndihet e pasigurt, të ndihet e **izoluar** dhe ndoshta fajtoje
- shpesh ajo bie në **depression**, perjeton **ankth dhe panik** dhe sjellje fobike.

Kjo mënyre jetese ka një ndikim të fortë në marrëdhënien si dhe në kujdesin ndaj fëmijëve gjithashtu dhe në vëmendjen ndaj nevojave emocionale të tyre. Për shumë nëna të fëmijëve të keqtrajtuar apo abuzuar dhuna përben një faktor në varferimin e brendshëm (e mardhenies, burime në të gjitha nivelet) deri në atë pike që i pengon ato të kryejnë veprime efektive.

Pasojat

- **Mungesa e vetëbesimit**, humbja e besimit në aftësitë e tyre
- **Pasiguria dhe paaftësia** për të vendosur
- **Ndjenja faji**, vetmi, dëshpërim
- **Frika per te komunikuar**, frika **per te mos qene e besueshme**
- **Frika se dhuna do te perseritet**



| FogiamAlice | SAUD |

SEPSE CDO DHUNE VRET NJE PJESE TENDEN

Vendet te zakonshme

(Stereotipet)

Besohet se...

- Eshte një fenomen i kufizuar
- I përket vetëm grupeve sociale të pafavorizuara, te lene pas dore, të privuara
- Eshte pasoja e një "problemi" i atyre që kryejnë dhunen: marrja e alkolit, drogës ose të meta te personaliteti.
- Eshtë rrjedhoje e nje "problemi" te burrave që në historinë e tyre familjare kanë qënë viktimat /ose deshmitar dhune.
- Se dhuna shtëpiake nuk ka efekt në shëndetin e grave.
- Duhet të gjejë zgjidhje brënda murave të shtëpise.
- Dhuna shtëpiake është shkaktuar nga raste dhe humbje sporadike të kontrollit
- Shkaktohet nga qëndrimet e grave: nxitese, të pakujdesshme dhe provokuese

Në realitet...

- Eshtë i përhapur edhe pse ende i panjohur dhe i nënvlerësuar
- Mund ti përkase cdokujt, çdo moshe dhe klasë sociale
- Eshtë e kryer nga burra që nuk tregojnë probleme të veçanta. Alkoli, Drogat dhe çrregullimet psikiqe munt të rendojne situatën.
- Studimet tregojnë që jo te gjithë femijët viktimat te dhunës /ose deshmitar bëhen burra te dhunshëm.
- Ndikon keq në mirëqenien psikofizike të grave.
- Eshtë e rëndësishme që dhuna të dali në pah dhe që të trajtohet me ndihma të jashtme
- Rrahja është një "strategji" që ka për qëllim për të ndryshuar sjelljen e tjetrit
- Asnje sjellje e grave mund të justifikojë përdorimin e dhunës

H e s h t j a e s h t e a r m i k u y t 2 0 1 8

KJO ESHTË RRUGEDALJA



25 nentor
dita internacionale
kunder dhunes
ndaj grave

Keshilla te dobishme

Duke pasur parasysh se dhuna ndaj grave ndodh në të gjitha sjielljet, veprimet dhe kërcënimet që mund të shkaktojnë **dhimbje** fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike, është e përshtatshme që ju, nese jeni viktimë, të kërkonit ndihmë menjëherë, **pa frenim apo frikë**, por me besim dhe vendosmëri.

Nëse agresori të len **shënja ose plaga**, shko në **urgjenca** për kujdesin e duhur, do të te jepet dhe një certifikatë mjekësore.

Duhet ta dish se ka **qendra të anti-dhunës**, të gatshëm për të dëgjuar dhe të japin të gjitha llojet e informacionit dhe këshilla, si psikologjike dhe ligjore; atje, në fakt, ju do të gjeni operatorët me trajnim të veçantë, në dispozicion për të dëgjuar historinë tuaj, për t'ju mbështetur dhe për të ndihmuar të dilni nga situata të dhunshme që po perjetoni, **në rrespektin e privacit** dhe, në qoftë se ju dëshironi, anonimitetin tuaj.

Gjithmonë me **miratimin tuaj**, operatorët do të jenë në gjendje për tju vene në kontakt me shërbimet më të përshtatshme për ju, mjekësore apo shërbimet sociale, ne Ambulanzat, policia ... domethene, për të gjitha llojet e këshillave, dhe të ju shoqërojë, nëse ju dëshironi, në takimet e para.

Nëse nuk dini si të gjeni qëndren më të afert, mund të shkoni ne shërbimin social te komunës tuaj, ose mund të telefononi numrin falas



1522

KUNDER-DHUNES
GRUA 24 ORE NE 24



Heshtja eshte armiku yt 2018



CFARE MUND TE BEJ? NESE PESON DHUNE

NESE E SHIHNI DIKE
QE PO I NENESHTROHET

TELEFONO



1522

KUNDER-DHUNES
GRUA 24 ORE NE 24



Heshtja eshte armiku yt 2018

Normativa internacionale

Më 1 gusht 2014 hyri në fuqi "Konventi i Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje" (Konventa e Stambollit). Kjo është një marrëveshje detyruese, e nënshkruar nga vendet anëtare të Këshillit të Evropës, e cila kërkon nga shtetet anëtare të marrin të gjitha masat e nevojshme, në tre shtigjet kryesore për:

- **parandalimin e dhunës:** përmes fushatave dhe programeve që synojnë rritjen e autonomisë dhe fuqizimin e grave; programe shkollore edukative mbi çështjet e barazisë gjinore dhe respektit reciprok, për studentët e të gjitha niveleve; zhvillimin dhe zbatimin e rregullave për mediat dhe në përgjithësi në fushën e informacionit dhe komunikimit; trajnimin e nevojshëm të profesionistëve të ndryshme të përfshirë në mbështetjen e viktimave ose trajtimin e autoreve të dhunës;

- **mbrojtja e viktimave:** mbrojtja e viktimës nga aktet e reja të dhunës, duke dhene prioritet nevojave specifike të viktimave, përmes bashkëpunimit efektiv ndërmjet të gjitha organet perkatese (organet gjyqësore, policisë, shërbimit shëndetësor, shërbimet sociale, shoqatat dhe organet jo qeverisese, etj); informacion në kohë për viktimën për shërbimet mbështetëse (këshillim psikologjik, keshilltar ligjor në kërkim të punës, strehim) dhe masave ligjore të disponueshme; mbështetja dhe ndihma në paraqitjen e denancimit; krijimi i qendrave strehimore adeguate; linja telefonike falas (në Itali është aktiv numri 1522 Anti-dhunës); Mbrojtja dhe mbështetja për dëshmitarët fëmijë të të gjitha formave të dhunës; te jepet garanci se do te merren ne konsiderate rastet e dhunës si dhe në çdo kohë autoriteti do të përcaktojë të drejtat e kujdestarisë dhe vizita e fëmijëve, ushtrimi i të cilave nuk mund të rrezikojë sigurinë dhe të drejtat e viktimës ose fëmijëve;

Heshtja eshte armiku yt 2018

- **dënimi i autorit të akteve të dhunës:** te garatoje denimin e veprave të kryera me masen e duhur të denimit në baze të rendesise së fakteve në mënyrë që të jete bindese; monitorim dhe mbikqyrje e personit të dënuar; garanci në interesin më të mirë të fëmijës, madje edhe aplikimin e kufizimeve mbi përgjegjësinë prindërore të autorit.

Mund të shkarkoni Konventën së Stambollit në:

http://www.consiglio.regione.fvg.it/pagine/pariopportunita/pagine/allegati/convenzione_Istanbul_violenza_donne.pdf

Normativa italiane

Sjelljet e dhunshme, të gjitha, përbëjnë vepra penale të dënueshme nga ligji italian, qoftë ajo fizike, morale, psikologjike apo seksuale; gjithashtu përbëjnë krim edhe sjelljet përndjekse (stalking). Në përgjithësi, me përjashtim të krimit më të rënda (p.sh. dhuna në familje, dëmtim serioz, tentim vrasje, disa raste të dhunës seksuale, disa raste stalking), është e nevojshme që viktima në mënyrë specifike të kërkojë (me anë të padisë) që të nisi procedimi kundër autorit (vepra ndiqet penalisht vetëm duke bere padi).

Në raste të rënda, megjithatë, edhe pa kërkesën e viktimës, hapet një procediment penal rreth autorit të dhunës kriminel procedurat gjyqësore kundër dhunës, sa herë që autoritet gjyqësor ose një zyrtari publik vjen në diheni se faktit të dhunshme (krimet ndiqen penalisht zyrtarisht).

Në faqen e internetit të Komisionit:

http://www.consiglio.regione.fvg.it/pagine/pariopportunita/pagine/allegati/riferimenti_normativi.pdf

Instrumentet ligjore të mbrojtjes së menjëhershme të viktimës

Në rastet e sjelljes së dhunshme që përbëjnë krim, veçanërisht në rastet e krimeve që ndiqen penalisht, mund të merren masa menjëherë, të cilat shërbejnë për të mbrojtur viktimën, të tilla si:

- largimin e personit të dhunshem nga shtëpia familjare;
- ndalimi për personin e dhunshem për qasje, kontakt dhe komunikim me viktimën, si dhe për tu afruar në vende zakonisht të frekuentuara nga viktima (domethëne, përveç strehimit shtëpiak, vendin e punës, ose shkolla);
- masa që kufizojnë lirinë në raste të rënda (p.sh. Paraburgimit, arrest shtëpiak.) në rastet me të rënda;
- në raste stalking, **denimi i autorit të persekutimit** nga Kuestori.

Per të gjitha rastet e dyshimta brenda banesës, mund ti kerkohet gjyqtarit, më ane te procedurës civile, masat mbrojtëse së largimit të autorit te dhunes nga shtëpia, së bashku me urdhërin kufizues per qasje apo dhe komunikim.

Në Qendrat e Anti-Dhuna së Rajonit Friuli Venezia Giulia, ju mund të merrni të gjitha informacionet ligjore dhe mbështetjen e nevojshme për të paraqitur ankesën dhe nëse është e nevojshme të kërkojë aplikimin e masave mbrojtëse.

Normativa rajonale

Rajoni FVG që në vitin 2000 promovon dhe financon, nepërmjet L.R. 17/2000, "projekte kundër-dhune" të qeverise lokale dhe të organizatave femerore të rajonit lokal (Qendra kundër-dhunes).

Qendrat kunder-dhune

Trieste

GOAP

Via San Silvestro, 3/5 – Trieste
Tel. 040 347 8827 - fax 040 347 8856
info@goap.it
<http://www.goap.it>

Pordenone

VOCE DONNA

Viale Cossetti, 16 – Pordenone
Tel e fax 0434 21 779
voicedonnapn@gmail.com
<http://www.voicedonnapn.it>

Gorizia

SOS ROSA

Via Diaz 5 – Palazzo Alvarez – Gorizia
Tel. e fax 0481 32 954
sosrosa@yahoo.it
<http://www.sosrosa.it/>

NGA GRUA NE GRUA

Via Roma, 13 – Ronchi Dei Legionari
Tel. 0481 474 700
info@dadonnaadonna.org
<http://www.dadonnaadonna.org>

Udine

IOTUNOIVOI DONNE INSIEME

Via Martignacco, 23 – Udine
Tel. 0432 421 011 – fax 0432 485 550
ass.idi@infinito.it
<http://www.wiotunoivoi.it>

ZERO TOLERANCE

Contro la violenza sulle donne
Via San Valentino 20 – 3°p – Udine
Numero Verde 800 531 135
zerotolerance@comune.udine.it
<http://www.comune.udine.it>

Falenderime

Komisioni rajonal për mundësitë e barabarta midis burrave dhe grave falenderon për bashkëpunimin Institutin Shtetëror të Artit "Giovanni Sello" në Udine për gatishmërinë e tyre për të siguruar fotot e autorëve / studenteve:

COSSETTINI Micaela
 COSTANZO Chiara
 DI MAIO Simona
 FORGIARINI Alice
 CANDERAN Chiara
 FEDELE Moreno
 LANTIERI Jessica

Mësuesit Annalisa COMUZZI e Adriano LECCE.

Një falenderim i veçantë i përkushtohet Qëndres kundër-dhunes GOAP i Triestes dhe shërbimit ZERO TOLERANCE – Kundër-dhunës ndaj grave, së komunës i Udines dhe qëndres kundër-dhunes SOS Rosa i Gorizias, që punoi me ne për krijimin e broshurës.

Falenderojmë shoqatën e ndërmjetësve kulturore INTERethNOS Onlus dhe Blerta ALUSHANI e cila ka bërë revizionimin e tekstit në gjuhën shqipe.



Rajoni Autonom Friuli Venezia Giulia
 Keshilli Rajonale
 Servici Organi di Garanzia
 Komisioni për mundësitë e barabarta midis burrave dhe grave

Kontakte
 Piazza Oberdan n. 6 34132 TRIESTE
 Tel. 040/3773202
 cr.organi.garanzia@regione.fvg.it

Faqja e internetit:
<http://www.consiglio.regione.fvg.it/pagine/pariopportunita/default.asp>



Heshtja eshte armiku yt 2018